


IMPAKTI I COVID-19 NË SEKTORIN E TIK-UT NË KOSOVË #COVID-19

STIKK, gjatë javës së fundit ka qenë duke mbledh të dhëna nga kompanitë anëtare lidhur me impaktin e pandemisë COVID-19 në sektorin tonë përmes një pyetësi të shpërndarë tek të gjithë anëtarët e shoqatës. Në vijim po i shpalosim të gjeturat nga ky hulumtim.


SA PUNONJËS I KA BIZNESI JUAJ NË LISTËN E PAGAVE?



- A. 1 - 10 Punonjës **21.7%**
- B. 11 - 50 Punonjës **65.3%**
- C. 51 - 100 Punonjës **13%**
- D. 101+ Punonjës **0%**

Fillimisht, është e qartë se shumica e kompanive anëtare të STIKK janë kompani të mesme dhe në listën e tyre të pagave kanë një numër të konsiderueshëm të punonjësve që sigurisht ndikon në gjendjen financiare të kompanive.


A KA BIZNESI JUAJ AKTUALISHT PLANE PËR TË ZVOGËLUAR FUQINË PUNËTORE PËR VITIN 2020 SI REZULTAT I COVID-19?



- A. Po **39.1%**
- B. Jo **30.4%**
- C. Nuk e di **30.4%**

Duke e marrë për bazë peshën që numri i caktuar i punonjësve e ka për një kompani, si dhe gjendjen aktuale të shkakuar nga COVID-19, disa nga kompanitë do të duhet të zvogëlojnë numrin e punonjësve (**39.1%**) në mënyrë që ta përballojnë këtë krizë.

A KA BIZNESI JUAJ AKTUALISHT PLANE PËR TË ZVOGËLUAR KOMPENZIMET PËR PUNONJËSIT?



- A. Qëndrojnë të njëjta **56.5%**
- B. Zvogëlohen përkohësisht **34.8%**
- C. Në baza vullnetare **4.3%**
- D. Ndryshim i detyrueshëm **4.3%**

Kur janë në pyetje kompensimet e punonjësve, lajm i mirë është se shumica e kompanive (**56.5%**) do ta mbajnë nivelin e njëjt të kompensimeve, e edhe në raste kur do të ketë zvolgëlime ato do të jenë të përkohshme (**34.8%**) deri sa situata të kthehet në normalitet.


CILAT JANË INDUSTRI TË ME TË CILAT BASHPUNONI

- Advertising / Marketing **26.09%**
- Art / Culture **0.00%**
- Associations / Federations **4.35%**
- Electronics **21.74%**
- Automobile **4.35%**
- FinTech **17.39%**
- Company / Economy / Finance **47.83%**
- Information / Telecomm **73.91%**
- Consulting **34.78%**
- Education / Training **43.48%**
- Fashion / Lifestyle **13.04%**
- Food / Drinks **13.04%**
- Law / Politics / Society **8.70%**
- Logistics / Transport **13.04%**
- Health Care **30.43%**
- Market Research **8.70%**
- Science / Research **8.70%**
- Tourism / Travel **13.04%**
- Trade / E-Commerce **39.13%**
- Real Estate **17.39%**
- Të tjera **17.39%**

Është mjaft evidente se sot teknologjia është pjesë e secilës industri e këtë e dëshmojnë edhe anëtarët tanë të cilat bashkpunojnë me industri dhe sektore të ndryshme e ku dominojnë:


Information/Telecomm (**73.91%**), Company/Economy/Finance (**47.83%**), Education/Training (**43.48%**), dhe Trade/E-Commerce (**39.13%**).

A JENI DUKE PUNUAR NGA SHTËPIA SI REZULTAT I PANDEMISË COVID-19?



Pas shpalljes së gjendjes emergjente shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19, pothuajse të gjithë nga anëtarët tanë janë duke zhvilluar veprimtarinë e tyre duke punuar nga shtëpia.


CILAT MJETE TË BASHKPUNIMIT PËRDOREN NË KOMPANINË TUAJ?



- A. Asana **2%**
- B. Jira **17.6%**
- C. Trello **19.6%**
- D. Confluence **7.8%**
- E. Google Drive **23.5%**
- F. OneNote **5.9%**
- G. Të tjera (Zoom, Discord, Skype...) **23.5%**

Vetë natyra e verprimtarisë së kompanive anëtare të STIKK është e tillë që përdorimi i mjeteve të ndryshme të bashkëpunimit për të komunikuar si me klient, poashtu edhe me stafin e tyre. Disa nga më të përdorurat janë: Google Drive (**23.5%**), Trello (**19.6%**) dhe Jira (**17.6%**).


CILAT MJETE TË VIDEO-KONFERENCAVE PËRDOREN NË KOMPANINË TUAJ?



- A. Asana **0%**
- B. Skype **27.7%**
- C. Zoom **14.9%**
- D. Slack **14.9%**
- E. Microsoft Teams **17%**
- F. GoToWebinar **0%**
- G. Të tjera (Discord, Meet, WebEX...) **25.5%**

Duke e marrë parasysh se shumica e takimeve në këtë kohë pandemie janë duke u realizuar online, kompanitë tona anëtare për video-konferenca kryesisht preferojnë të përdorin: Skype (**27.7%**), Microsoft Teams (**17%**), Zoom (**14.9%**) dhe Slack (**14.9%**).

A I KENI PËRDORUR KËTO MJETE TË BASHKPUNIMIT MË HERËT?



- A. Po, shumicën prej tyre **83%**
- B. Disa prej tyre **17%**
- C. Jo, shumicën për herë të parë **0.00%**


Kompanitë tona anëtare veçse përdorin shumicën e mjeteve të lartpërmendura për bashkëpunim dhe komunikim.

SI DO TË JETË GJENDJA E BIZNESEVE PAS PANDEMISË COVID-19? ÇFARË IMPAKTI DO TË KETË KJO PANDEMI NË INDUSTRIJË DIGJITALE

- Do të pëshpejtohet ritmi i transformimeve digjitale **86%**
- Mjetet e komunikimit dhe të bashkpunimit si Slack, Asana, Microsoft Teams, etj. do të kenë rol më të rëndësishëm **55%**
- Puna nga shtëpia do të jetë më e pranueshme se më parë **82%**
- Telekonferencat dhe takimet online do të shpeshohen ndërsa udhëtimet do të limitohen më shumë **64%**
- Mbrojtja e të dhënave dhe siguria kibernetike do të kenë rëndësi të shtuar **68%**
- Zgjerimi i Internetit do të përshejtohet **50%**


Pandemia COVID-19 padyshim që do të ketë ndikim edhe në industrinë digjitale dhe do të ndryshoj mënyrën se si kjo industri funksionon. **86%** besojnë se situata e shkaktuar do të përshejtoj ritmin e transformimeve digjitale në shumë industri të ndryshme. Vlen të ceket fakti se **82%** e anëtarëve e konsiderojnë se puna nga shtëpia tash e tutje do të jetë më e pranueshme se më parë.

SI DO TË NDIKOJ PANDEMIJA COVID-19 NË GJENDJEN E PËRGJITHSHME TË EKONOMISË DIGJITALE




Rreth qështjes së gjendjes së përgjithshme të ekonomisë digjitale dhe efektin që COVID-19 do ta ketë në të, është mjaft interesant fakti se pothuajse numri i barabart i kompanive janë të ndara në dy fronte, njëri front që beson se ekonomia digjitale do të përfitoj me kalimin e pandemisë (**26%**) ndërsa fronti tjetër i cili parasheh humbje afatgjate të të hyrave (**30%**).

SI KA NDIKUAR PANDEMIA COVID-19 NË BIZNESIN E KOMPANISË TUAJ?



Sikurse në çdo industri dhe sektor tjetër, si në vendin tonë e poashtu edhe anë e mbanë botës, pandemia COVID-19 ka patur kryesisht ndikim negativ në biznes bërjen e kompanive tona anëtare (61%).

A JENI TË BRENGOSUR PËR KOMPANINË/PUNËN TUAJ?



Krejt në fund, anëtarët u pyetën se sa të brengosur janë për kompaninë e tyre dhe efektin që COVID-19 do ta ketë në atë dhe shumica prej tyre (78%) duket të jenë mjaft të brengosur për të ardhmen e tyre.